



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Qershor 2021

Nr. 383

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Partisë Socialiste, qarku Gjirokastrë.

Kërkues: z. Vangjel Tavo

Ndaj: Partisë Socialiste, qarku Gjirokastrë

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREJ:

I. Vlerësimi paraprak



Data: 2 Qershor 2021

Nr. 383

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Partisë Socialiste, qarku Gjirokastrë

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është përcjellë denoncimi i z. Vangjel Tavo nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, i cili është administruar në KQZ me nr. 3705 prot., datë 13.4.2021, për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncuesit pretendohet se: *“Subjekti politik Partia Socialiste ka mbushur magazinat e Drejtorisë së Zjarrfikësve në Gjirokastrë, duke i nxjerrë këta të fundit jashtë, me tonelata ushqimesh për ti shpërndarë tek banorët në shkëmbim të votës”*.

Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit është paraqitur dhe një fotografi, ku sipas denoncuesit vërtetohet pretendimi i tij.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’ a njeh shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht denoncimin, vlerësoi se provat ku denoncimi bazohet, nuk kanë vlerë provueshmërie për të konstatuar nëse ka shkelje apo jo, pasi në fotografinë e paraqitur nuk ka asnjë element vërtetues, për tu konsideruar si indicie për nisjen e hetimit administrativ.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative ndaj subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, qarku Gjirokastrë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

